

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 625 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 64, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Handrianopolis"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dhimitër Çondi dhe Prof. Roberto Perna, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Handrianopolis"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dhimitër Çondi dhe Prof. Roberto Perna, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Sondazhe: në zonën perëndimore të Teatrit në sektorin A/W, në sektorin 7 planifikohet të përfundohet gërmimi i nisur në vitin 2014, në sektorin 5-6, gjithashtu parashikohet të përfundojnë gërmimet e nisura në vitin 2014.
 - Kërkimet në zonën ekstra-urbane. Ky aktivitet synon të kontribuojë në valorizimin e potencialit turistik të zonës. Veprimtaria do të përqendrohet në zonën e Luginës së Drinosit dhe në Jergucat.
 - Restaurimi. Në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Monumenteve të Kulturës do të realizohen ndërhyrjet konservuese dhe konsoliduese si për gjetjet e vogla, ashtu edhe për strukturat që janë zbuluar gjatë kërkimeve të bëra në vitet 2012-2014.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO